



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“ZHVILLIM WEBSITE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

T3-IV-21

Tiranë, 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	ZHVILLIM WEBSITE			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	T3-IV-21
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Zhvillim website”, niveli IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, është <i>zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin e teknikut për zhvillim website, për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit</i>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Zhvillim website” të nivelit IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar kualifikimin profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, nivelin II në KSHK referuar nivelit II të KEK - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - kanë aftësi ndryshe, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Zhvillim website”, niveli IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë. Pas nivelit IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare në degët e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit, Elektronikës, dhe jo vetëm. Ky kualifikim i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës <i>për t’u punësuar apo vetëpunësuar në pozicionet e teknikut të zhvillimit të website pranë kompanive të ndërtimit të website, mediave, njësive të shërbimit turistik, institucioneve dhe bizneseve të dimensioneve të ndryshme (në institucione shtetërore, arsimore, në banka, në kompanitë e postës dhe telekomunikacionit, në njësitë e shërbimit turistik, në kompani transporti, agjenci pasuri të patundshme, kompani sigurimi, në njësitë e pushtetit lokal etj.) etj., mund të punojë dhe online.</i>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	T3-IV-10			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Menaxhimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë dinamikat e zhvillimit të sektorit të ndërtimit të websiteve në vend dhe botë;
- Të përshkruajë legjislacionin në fushën e TIK(standardet kryesore, copyright etj.);
- Të përshkruajë legjislacionin e punës dhe të biznesit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mirë planifikimit të burimeve dhe veprimtarive të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimit, si dhe mënyrat dhe formatet përkatëse
- Të dallojë mjetet dhe pajisjet, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të ilustrojë me shembuj praktika të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të shpjegojë rëndësinë e të punuarit nën presionin e kohës;
- Të përshkruajë tendencat e zhvillimit të teknologjive në fushën e dizenjimit dhe ndërtimit të websiteve.
- Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të mbrojtjes së mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe ruajtjes së të skedarëve të website-it në foldera;

Analizimi i kërkesave

- Të shpjegojë rëndësinë e mbledhjes dhe studimit paraprak të kërkesave dhe informacioneve të nevojshme;
- Të shpjegojë format dhe metodat për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë së TIK;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të qëllimit të faqes web;
- Të përshkruajë fazat të punës (workflow-un) dhe mënyra e interpretimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të audiencës dhe mënyra e adresimit ndaj saj;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknikave të marketingut;
- Të listojë motorët e kërkimit dhe teknikat e optimizimit (SEO);

Dizenjimi grafik

- Të listojë parimet e dizenjimit grafik (Pozicionimi, Përsëritja, Kontrasti, Afërsia, Tipografia dhe Layout);
- Të përshkruajë mënyrat e paraqitjes së informacionit në website;
- Të përshkruajë strukturën e faqeve përbërëse;
- Të shpjegojë teorinë e ngjyrave;
- Të dallojë imazhet vektoriale nga ato matricore;

- Të listojë formatet kryesore të skedarëve grafik;
- Të dallojë tipet e skedarëve grafike që përdoren në web;
- Të përshkruajë procesin e përshtatjes së imazheve për web;
- Të përshkruajë platformat dhe programet e dizenjimit grafik (Photoshop, Adobe XD, Figma etj.);

Konfigurimi i platformës së hostimit

- Të shpjegojë llojet e sistemeve të hostimit web dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë parametrat harduere të nevojshme për hostim;
- Të përshkruajë teknikat e instalimit dhe konfigurimit të platformave dhe programeve të përdorura për transferimin e skedarëve në web server;
- Të listojë ofruesit e shërbimit domain dhe llojet DNS;
- Të përshkruajë teknikat e konfigurimit të e-mail server-it;
- Të përshkruajë teknikat për regjistrimin e domain dhe menaxhimin e rekordeve DNS nëpërmjet platformave të ngjashme me cloudflare;
- Të përshkruajë ndërfaqet e menaxhimit të hostit si: cpanel, plesk, etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të teknologjive të hostimit;
- Të përshkruajë teknikat analizimit dhe optimizimit të hostit;

Zhvillim frontend

- Të diskutojë mbi zhvillimet bashkëkohore të teknikave në frontend;
- Të listojë mjedise të ndryshme të zhvillimit në frontend;
- Të listojë CMS të ndryshme për ndërtimin e websiteve;
- Të analizojë rolin e protokollove të komunikimit (P.sh. HTTP3, HTTPS, 4 etj.);
- Të listojë llojet më të përdorura të librarive në frontend;
- Të krahasojë llojet e librarive në frontend;
- Të interpretojë mjetet e zhvillimit në një shfletues (browser) të caktuar që përdoren për zhvillimin në frontend;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML/HTML5 për strukturimin e faqeve web;
- Të dallojë komandat HTML semantike;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML për formatimin e tekstit të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML për ndërtimin e formave të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML për ndërtimin e grafikave, tabelave, listave të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML për futjen audiove, videove, plugin-ve dhe mediave të tjera;

- Të përkufizojë API;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës dhe komandat e gjuhës HTML për API;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës CSS për stilimin dhe formatimin e tekstit, layout-it, tabelave, listave, imazheve, butonave, formave, link-ve të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës CSS për përdorimin e klasave, id-ve, për stilimin elementeve të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës CSS për transformimet, tranzicionet, animacionet të elementeve të faqeve web;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës CSS për ndërtimin e faqeve web responsive;
- Të përshkruajë teknikat e ndërtimit të layout-it të faqeve web nëpërmjet HTML dhe CSS nëpërmjet një framework-u;
- Të përshkruajë problematikat në përshtatjen e kodit për browser-a të ndryshëm;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të faqeve web për pajisjet mobile (celularë) nëpërmjet një framework-u;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit dhe prezantimit të prototipit;
- Të përshkruajë teknikat e testimit të frontend;
- Të listojë llojet e gabimeve në frontend;

Bazat e të dhënave relacionale – MySQL

- Të diskutojë mbi zhvillimet bashkëkohore të përdorimit të MySQL;
- Të përshkruajë funksionet e MySQL;
- Të listojë rregullat sintaksore;
- Të listojë terminologjinë e RDBMS;
- Të përshkruajë ndërveprimin me sistemet e operimit dhe gjuhët e tjera si: PHP, C, C++, JAVA etj.;
- Të listojë komandat për ekzekutimin dhe mbylljen e MySQL Server;
- Të përshkruajë sintaksën për vendosjen e një llogarie të përdoruesit MySQL;
- Të listojë komandat Administrative të MySQL si: USE Databasename, SHOW Databases , SHOW TABLES, SHOW COLUMNS FROM tablename etj.;
- Të përshkruajë komandën e PHP për të thirrur një funksion MySQL;
- Të përshkruajë lidhjen e MySQL duke përdorur skriptet e PHP;
- Të përshkruajë tipet e të dhënave në MySQL;
- Të përshkruajë komandat për krijimin e objekteve;
- Të përshkruajë komandat për modifikimin e objekteve;
- Të përshkruajë funksionin e operatorëve special;
- Të interpretojë afishimin e të dhënave nëpërmjet query-eve dhe index;
- Të përshkruajë përzgjedhjen e bazës së të dhënave MySQL nga komanda e shpejtë: Select, Where, Joins;
- Të interpretojë importimin dhe eksportimin e bazës së të dhënave;
- Të përshkruajë transaksionet e bazës së të dhënave;

Zhvillim backend

- Të diskutojë mbi zhvillimet bashkëkohore të teknikave në backend;
- Të listojë mjedise të ndryshme të zhvillimit në backend;
- Të shpjegojë funksionalitetet në backend;
- Të listojë llojet më të përdorura të librarive në backend;
- Të përshkruajë rregullat e sintaksës së gjuhëve PHP, Python, Java etj. për implementimin e faqeve web;
- Të përshkruajë komandat e gjuhës PHP, Python, Java etj. për implementimin e faqeve web;
- Të përshkruajë teknologjitë DBMS si: MySQL, Oracle, SQLServer ,NoSQL për gjetjen, ruajtjen ose ndryshimin e të dhëna;
- Të përshkruajë teknologjitë DBMS si: MySQL, Oracle, SQLServer, NoSQL për t'ia shërbyer të dhënat përsëri përdoruesit në kodin frontend;
- Të përshkruajë arkitekturën e server;
- Të shpjegojë metodologjinë API;
- Të menaxhojë burimet e API-ve që funksionojnë në të gjithë pajisjet;
- Të përshkruajë algoritmet për zgjidhjen e problemeve që lidhen me sistemin;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit dhe prezantimit të prototipit;
- Të shpjegojë metodologjinë e optimizimit të sigurisë së të dhënave;
- Të përshkruajë teknikat e testimit të backend;
- Të listojë llojet e gabimeve në backend;

Javascript

- Të diskutojë mbi zhvillimet bashkëkohore të përdorimit të gjuhës së Javascript;
- Të listojë rregullat sintaksore dhe llojet e variablave të gjuhës Javascript;
- Të listojë fjalët e rezervuara në Javascript;
- Të përshkruajë tipet e të dhënave në gjuhën Javascript;
- Të listojë operatorët aritmetikë, krahasimit, inkrementimit, dekrementimit, logjik dhe të vlerë dhënies në Javascript;
- Të listojë strukturat e kontrollit në gjuhën Javascript;
- Të përshkruajë strukturat e kontrollit në gjuhën Javascript;
- Të përshkruajë përdorimin e cikleve të përsëritjes në gjuhën Javascript;
- Të përshkruajë funksionet e gjuhës Javascript;
- Të përshkruajë OOP në typescript:
- Të përshkruajë teknika të konfigurimit dhe implementimit të typescript:
- Të përshkruajë përdorimin e objekteve në gjuhën Javascript;
- Të përshkruajë përdorimin e eventeve në gjuhën Javascript;
- Të dallojë funksionet e gatshme në gjuhën Javascript;
- Të listojë mënyrat e menaxhimit të gabimeve në gjuhën Javascript;
- Të përshkruajë kontrollin e navigimit nëpërmjet gjuhës Javascript (ridrejtim, back

etj.);

- Të përshkruajë leximin/modifikimin e objekteve të DOM (Document Object Model) nëpërmjet gjuhës Javascript;
- Të përshkruajë përdorimin e JSON;
- Të listojë llojet e modelimit të objekteve në browser;
- Të përshkruajë funksionin e objektit XMLHttpRequest (Teknologjia AJAX);
- Të listojë llojet e librarive më të përdorura të Javascript;
- Të krahasojë llojet e librarive më të përdorura në Javascript;

Politikat e sigurisë

- Të shpjegojë rëndësinë e hulumtimit të vazhdueshëm të risqeve të mundshme në web;
- Të përshkruajë vulnerabilitetet që shfaqen në web dhe servera;
- Të përshkruajë politikat dhe procedurat e sigurisë që këshillohen në situata dhe nevojshmëri të ndryshme;
- Të përshkruajë përditësimin e certifikatave dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë nivelet e sigurisë së fjalëkalimeve dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të fjalëkalimeve;
- Të përshkruajë teknikat e enkriptimit të informacionit;
- Të përshkruajë aksesin e përdoruesve në panelin e faqes (IP-ve, kredencialeve, DNS etj.);
- Të përshkruajë mënyrat e ndryshme të bërjes së back-upeve në server (të plotë , të pjesshëm, manual etj.) dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë mënyra për asgjësimin e plotë të informacionit të destinuar të fshihet;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionin për autorësinë dhe privatësinë;
- Të shpjegojë teknikat për një rikuperim optimal dhe sa më të shpejtë pas një incidenti;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të burimeve sekondare ushqimi/ shërbimi në rast ndërprerje të burimit kryesor për Hostin;

Shërbime të mirëmbajtjes së website

- Të përshkruajë planin e mirëmbajtjes periodike të faqes;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit UI dhe UX;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit e nevojshme të web-faqes;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të gjuhëve, framework, librarive, platformave të programimit mbi të cilat është ndërtuar faqja;
- Të përshkruajë arsyet mënyrat e kontrollit të back-up (hash);
- Të listojë testet rutinë që aplikohen tek faqet web;
- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit të ekipeve mbi administrimin dhe mirëmbajtjen e faqes web;

Dokumentim i punës së kryer

- Të listojë llojet e dokumentacioneve teknike të përdorura në projekt;
- Të listojë elementët e dokumentimit të një projekti (teknologjitë e zhvillimit të programit, strukturën, funksionalitet, mjetet e zhvillimit, platformat);
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të layout-in dhe strukturës së faqes web nëpërmjet aplikacioneve (p.sh. si: Ms VISIO, Project etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të kodit burim sipas strukturave dhe funksionaliteteve;
- Të përshkruajë dokumentimin e strukturës UML, diagrama E-R etj.;
- Të përshkruajë dokumentimin e prototipit të faqeve (emërtim, argumente, funksionalitete, output);
- Të përshkruajë dokumentimin e procesin e punës (workflow);
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të problemeve të evidentuara dhe zgjidhjet e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të punëve dhe të mirëmbajtjeve të kryera;
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të kredencialeve të aksesimit të faqes sipas niveleve administrative;
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të udhëzuesve dhe manualeve të përdoruesit sipas niveleve të aksesit.
- Të përshkruajë dokumentimin në metodologjinë Agile;

Komunikimi

- Të përshkruajë format e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegë, eprorë dhe të tjerët;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të një komunikimi me etikë dhe profesional;
- Të argumentojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një komunikim;
- Të listojë parimet e punës në grup dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
- Të argumentojë mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me të tjerët;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë teknike të fushës në gjuhë të huaj;

SHPREHI PROFESIONALE

Menaxhimi dhe organizimi i punës

- Të ndjekë dinamikat e zhvillimit të sektorit të ndërtimit të websiteve në vend dhe botë;
- Të zbatojë legjislacionin në fushën e TIK;
- Të zbatojë legjislacionin e punës dhe të biznesit;

- Të kryejë mirëplanifikimin e burimeve dhe veprimtarive të punës;
- Të menaxhojë punën nën presionin e kohës;
- Të kryejë raportimin sipas mënyrave dhe formateve përkatëse;
- Të identifikojë mjetet dhe pajisjet sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë mënyrën e organizimit dhe ruajtjes së të skedarëve të website-it në foldera;

Analizimi i kërkesave

- Të përzgjedhë metoda për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave;
- Të mbledhë kërkesa dhe informacione të nevojshme;
- Të analizojë kërkesat e nevojshme;
- Të përdorë terminologjinë profesionale të TIK;
- Të përcaktojë funksionalitetet e faqes web;
- Të hartojë (workflow-un) fazat të punës duke respektuar afatet kohore;
- Të hulumtojë rreth audiencës së synuar;
- Të përdorë teknika të marketingut;
- Të përdorë motorët e kërkimit dhe teknikat e optimizimit (SEO).

Dizenjimi grafik

- Të zbatojë parimet e dizenjimit grafik (Pozicionimi, Përsëritja, Kontrasti, Afërsia, Tipografia dhe Layout);
- Të përzgjedhë mënyrat e paraqitjes së informacionit në website;
- Të ndërtojë strukturën e faqeve përbërëse;
- Të zbatojë rregullat e kombinimit dhe përdorimit të ngjyrave;
- Të përzgjedhë formatet kryesore të skedareve grafik;
- Të përdorë tipet e skedarëve grafike në web;
- Të përshtatë imazheve për web;
- Të përzgjedhë platformat dhe programet e dizenjimit grafik (Photoshop, Adobe XD, Figma etj.)

Konfigurimi i platformës së hostimit

- Të përcaktojë parametrat harduere të nevojshme për hostim;
- Të zbatojë teknikat e instalimit dhe konfigurimit të platformave dhe programeve të përdorura për web server;
- Të përzgjedhë sistemin e hostimit web;
- Të përzgjedhë domain-in dhe llojet DNS;
- Të konfigurojë e-mail server-in;
- Të zbatojë teknikat për regjistrimin e domain dhe menaxhimin e rekordeve DNS nëpërmjet platformave të ngjashme me cloudflare;

- Të konfigurujë hostin nëpërmjet ndërfaqeve të menaxhimit si: cpanel, plesk etj.
- Të zbatojë teknikat analizimit dhe optimizimit të hostit;

Zhvillim frontend

- Të analizojë specifikimet e kërkuara mbi dizenjimin e faqes web
- Të përzgjedhë editorin/IDE-në për programimin në frontend;
- Të përzgjedhë libraritë, framework të nevojshme për programimin në frontend;
- Të instalojë editorin/IDE-në/framework-un dhe libraritë e nevojshme
- Të përshtatë framework-un e zgjedhur duke respektuar dizenjimin grafik të kërkuar
- Të përdorë mjetet e zhvillimit në një shfletues (browser) të caktuar në frontend;
- Të realizojë strukturimin e kërkuar të faqes web duke përdorur HTML-në
- Të strukturojë sipas formatit të kërkuar përmbajtjet e tekst të faqeve web;
- Të strukturojë sipas formatit të kërkuar kontakt format duke përdorur HTML
- Të strukturojë sipas formatit të kërkuar grafikat, tabelat, listat në faqet web;
- Të strukturojë sipas formatit të kërkuar vendosjen e audiove, videove, plugin-ve dhe mediave të tjera;
- Të realizojë lidhjen e ndërfaqes me API të nevojshme;
- Të vendosë komente në të gjitha blloqet e kodit;
- Të identifikojë elementët e faqes web që do të stilohen duke përdorur CSS;
- Të zbatojë rregullat e sintaksës CSS për përdorimin e klasave, id-ve, për stilimin elementeve të faqeve web;
- Të zbatojë rregullat e sintaksës CSS për transformimet, tranzicionet, animacionet të elementeve të faqeve web;
- Të zbatojë rregullat e sintaksës CSS për ndërtimin e faqeve web për pajisjet mobile (celularë, faqe web responsive);
- Të zbatojë teknikat e ndërtimit të layout-it të faqeve web nëpërmjet HTML dhe CSS nëpërmjet një framework-u;
- Të optimizojë kodin për problematikat në përshtatjen me browser-a të ndryshëm;
- Të optimizojë faqet web për pajisjet mobile (celularë, faqe web responsive) nëpërmjet një framework-u;
- Të testojë vazhdimisht faqen web;
- Të korrigjojë gabimet e nxjerra nga testimet;

Bazat e të dhënave relacionale – MySQL

- Të hulumtojë zhvillimet bashkëkohore të përdorimit të MySQL;
- Të prezantojë funksionet e MySQL;
- Të zbatojë rregullat sintaksore;
- Të përdorë terminologjinë e RDBMS;
- Të realizojë ndërveprimin me sistemet e operimit dhe gjuhët e tjera si: PHP, C, C++, JAVA etj.;

- Të përzgjedhë komandat për ekzekutimin dhe mbylljen e MySQL Server;
- Të implementojë sintaksën për vendosjen e një llogarie të përdoruesit MySQL;
- Të ndërtojë komandat Administrative të MySQL si: USE Databasename, SHOW Databases , SHOW TABLES, SHOW COLUMNS FROM tablename etj.;
- Të implementojë lidhjen e MySQL duke përdorur skriptet e PHP;
- Të implementojë komandën e PHP për të thirrur një funksion MySQL;
- Të përcaktojë tipet e të dhënave në MySQL;
- Të implementojë komandat për krijimin e objekteve;
- Të implementojë komandat për modifikimin e objekteve;
- Të implementojë funksionin e operatorëve special;
- Të realizojë afishimin e të dhënave nëpërmjet query-eve dhe index;
- Të kryejë importimin dhe eksportimin e bazës së të dhënave;
- Të kryejë transaksionet e bazës së të dhënave;
- Të zbatojë procedurat e dhënies dhe heqjes së aksesit të përdoruesve në bazën e të dhënave;
- Të verifikojë aksesin, sigurinë dhe privatësinë e të dhënave;
- Të dokumentojë veprimet e kryera për bazën e të dhënave;

Zhvillim backend

- Të hulumtojë zhvillimet bashkëkohore të teknikave në backend;
- Të përzgjedhë mjedise të ndryshme të zhvillimit në backend;
- Të prezantojë funksionalitetet në backend;
- Të instalojë llojet e librarive, framework-eve në backend;
- Të zbatojë rregullat e sintaksës së gjuhëve (PHP, Python, Java etj.) për deklarimin e tipit të dhënave, variablave, konstanteve, operatorëve, objekteve, funksioneve, eventeve, metodave, kushteve kushtëzuese dhe ciklike etj. të faqeve web;
- Të implementojë komandat së gjuhëve (PHP, Python, Java etj.) për deklarimin e tipit të dhënave, variablave, konstanteve, operatorëve, objekteve, funksioneve, eventeve, metodave, kushteve kushtëzuese dhe ciklike etj. të faqeve web;
- Të integrojë gjuhët programuese me njëra-tjetrën (si : JS HTML DOM, JS Web APIs, JS AJAX, JS JSON, PHP OOP, PHP XML, Python MongoDB etj.);
- Të kryejë implementimin e teknologjive DBMS si: MySQL, Oracle, SQLServer për gjetjen, ruajtjen ose ndryshimin e të dhëna;
- Të kryejë implementimin e teknologjive DBMS si: MySQL, Oracle, SQLServer për t'ia shërbyer të dhënat përsëri përdoruesit në kodin frontend;
- Të zbatojë metodologjinë API;
- Të përdorë burimet e API-ve që funksionojnë në të gjithë pajisjet;
- Të kryejë algoritmet për zgjidhjen e problemeve që lidhen me sistemin;
- Të identifikojë mënyrat e kontrollit të ndërfaqes web;
- Të zbatojë metodologjitë për optimizimin e sigurisë së të dhënave;
- Të zbatojë teknikat e testimit të backend;

- Të raportojë llojet e gabimeve në backend;
- Të korrigjojë gabimet e mundshme;
- Të dokumentojë procesin e zhvillimit të programit;

Javascript

- Të deklarojë variablat në gjuhën Javascript;
- Të kryejë të gjitha llojet e veprimeve me variablat në Javascript;
- Të ndërtojë funksione javascript;
- Të thërrasë funksionet javascript nga një event;
- Të modifikojë objektet e DOM nëpërmjet kodit Javascript;
- Të përdorë funksionet e gatshme në Javascript;
- Të zbatojë teknika të OOP në typescript;
- Të konfigurujë dhe implementojë typescript;
- Të ndërtojë kod në Javascript për kontrollin e navigimit (ridrejtim, back etj.);
- Të modifikojë pozicionin e objekteve të DOM në faqen web nëpërmjet kodit Javascript (Layers, CSS, DHTML);
- Të modifikojë pamjen e objekteve të DOM (ngjyrën, etj.);
- Të modifikojë përmbajtjen e elementeve të DOM nëpërmjet javascript;
- Të realizojë kërkesa HTTP brenda faqes pa rifreskuar faqen nëpërmjet objektit XMLHttpRequest (Teknologjia AJAX);
- Të përzgjedhë libraritë e nevojshme në javascript;
- Të përdorë funksionalitetet e librarive Javascript;
- Të shtojë komente në skedarët e kodit në Javascript;
- Të testojë vazhdimisht kodin në Javascript;
- Të korrigjojë gabimet e nxjerra nga testimet;

Politikat e sigurisë

- Të hulumtojë vazhdimisht risqet të mundshme në web;
- Të dallojë vulnerabilitetet që shfaqen në web dhe servera;
- Të zbatojë/krijojë politikat dhe procedurat e sigurisë që këshillohen në situata dhe nevojshmëri të ndryshme;
- Të përditësojë certifikatat periodikisht;
- Të përcaktojë nivelet e sigurisë së fjalëkalimeve dhe përdorimet e tyre;
- Të përcaktojë periudhat e përditësimit të fjalëkalimeve;
- Të përzgjedhë teknikat e enkriptimit të informacionit;
- Të përcaktojë aksesin e përdoruesve në panelin e faqes (nëpërmjet: IP-ve, kredencialeve, DNS etj.);
- Të aplikojë mënyrat e ndryshme të bërjes së back-upëve në server (të plotë , të pjesshëm, manual etj.)
- Të kryejë asgjësimin e plotë të informacionit të destinuar të fshihet;
- Të respektojë legjislacionin për autorësinë dhe privatësinë;
- Të kryejë një rikuperim optimal dhe sa më të shpejtë në rast incidenti;
- Të sigurojë burimet sekondare ushqimi/ shërbimi në rast ndërprerje të burimit

kryesor për Hostin, nëse është lokal;

Shërbime të mirëmbajtjes së website

- Të hartojë një plan mirëmbajtjeje periodike të faqes;
- Të përditësojë UI dhe UX sipas nevojës.
- Të kryejë përditësimet e elementëve vizual dhe të përmbajtjes në frontend të web-faqes;
- Të kryejë përditësimet e gjuhëve, framework-ve, librarive, platformave të programimit mbi të cilat është ndërtuar faqja;
- Të kontrollojë integritetin e backup-eve;
- Të kryejë teste rutinë që aplikohen tek faqet web;
- Të koordinojë ekipet mbi administrimin dhe mirëmbajtjen e faqes web;
- Të kryejë përditësimin e teknologjive të hostimit;

Dokumentim i punës së kryer

- Të përdorë ose hartojë dokumentacionet teknike të një projekti web;
- Të dokumentojë elementët e një projekti web (teknologjitë e zhvillimit të programit, strukturën, funksionalitet, mjetet e zhvillimit, platformat);
- Të dokumentojë layout-in dhe strukturën e faqes web nëpërmjet aplikacioneve (p.sh. si: Ms VISIO, Trello etj.);
- Të dokumentojë kodin burim sipas strukturave dhe funksionaliteteve;
- Të përgatisë dokumentimin e strukturës UML, diagrama E-R etj.;
- Të dokumentojë prototipin e faqeve (emërtim, argumente, funksionalitete, output);
- Të dokumentojë procesin e punës (workflow);
- Të dokumentojë problemet e evidentuara dhe zgjidhjet e tyre;
- Të dokumentojë punët dhe mirëmbajtjet e kryera;
- Të dokumentojë kredencialet e aksesimit të faqes sipas niveleve administrative;
- Të hartojë udhëzuesit dhe manualët e përdoruesit sipas niveleve të aksesit.
- Të përgatisë raporte teknike.
- Të zbatojë metodologjinë Agile në dokumentimin;

Komunikimi

- Të respektojë rregullat e komunikimit etikë dhe profesional me kolegë, eprorë dhe të tjerët;
- Të menaxhojë stresin;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë teknikat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me të tjerët;
- Të përdorë terminologjinë teknike të fushës në gjuhë të huaj;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

Akronime

IDE -Integrated Development Environment
 SEO -Search Engine Optimization
 DNS - Domain Name System
 HTTP - Hypertext Transfer Protocol
 HTTPS - Hypertext Transfer Protocol Secure
 HTML - HyperText Markup Language
 API - Application Programming Interface
 PHP - PHP: Hypertext Preprocessor
 DBMS - Database Management System
 DOM - Document Object Model
 JSON - JavaScript Object Notation
 AJAX - Asynchronous JavaScript And XML
 RDBMS - Relational Database Management System
 IP - Internet Protocol
 UML - Unified Modeling Language
 CSS - Cascading Style Sheets
 CMS - content management system
 UI- User Interface
 UX- User Experience
 XML - eXtensible Markup Language

MySQL- My Structured Query Language
NoSQL- Not only Structured Query Language
ORACLE- Oak Ridge Automatic Computer Logical Engine